

VENDIM
Nr.523, datë 11.12.1992

PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR ANËTARËT E KËSHILLIT TË RRETHIT, BASHKISË E KOMUNËS DHE KRYEPLAKUT (KRYETARIT) TË FSHATIT

Në mbështetje të nenin 58 të ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal", Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e këshillit të rrethit, komunës, bashkisë dhe kryeplaku (kryetari) i fshatit që punojnë në institucione e ndërmarrje buxhetore, për ditët që marrin pjesë në mbledhje, nuk marrin shpërblim, por u jepet paga përkatëse ditore nga qendra e punës, kurse këshilltarët e tjerë dhe kryepleqtë shpërblehen nga këshilli përkatës në nivelin e pagës ditore të tyre, por jo më shumë se 200 lekë dhe jo më pak se 75 lekë në ditë.

2. Këshilltarët, për veprimtarinë që kryejnë, shpërblehen:

a) anëtarët e këshillit të komunës, bashkisë dhe rrethit me 450 lekë në muaj, kurse anëtarët e këshillit të Bashkisë së Tiranës 700 lekë në muaj;

b) kryetari i këshillit të komunës për komunat me mbi 10.000 banorë 600 lekë dhe për komunat me nën 10.000 banorë 500 lekë në muaj.

c) kryetari i këshillit të bashkisë për Bashkinë e Tiranës 1100 lekë, për bashkitë e kateegorisë së parë 750 lekë, për bashkitë e kategorisë së dytë 600 lekë dhe për bashkitë e kategorisë së tretë 500 lekë në muaj;

ç) anëtarët e kryesisë së këshillit të rrethit 600 lekë në muaj;

d) kryelaku (kryetari) i fshatit për fshatrat me nën 500 banorë 450 lekë, me 501 deri në 1000 banorë 600 lekë dhe me mbi 1500 banorë 750 lekë në muaj.

3. Për efekt dietash, anëtarët e këshillave të komunave, bashkive e rretheve, drejtuesve të tyre dhe kryeplakut (kryetari) të fshatit që janë me punë private, niveli i pagës bazë u llogaritet 2400 lekë në muaj.

4. Për vitin 1993 Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të parashikojë në buxhetin e organeve të pushtetit lokal në rrethe, komuna e bashki 60 milionë lekë shtesë për efekt të zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi